

Shlyerja/kefareti në rastin kur nuk bën be

Mexhmu Fetaua ue Mekalat Muteneuije li Semahat esh-Shejh el-Alameh AbduAziz bin Baz 9/43

Pyetje: Jam një i ri që i kam premtuar Allahut se do të lexojë disa fletë në ditë të tefsirit të shkurtuar të Ibn Kethirit, por s’e kam përmbushur këtë premtim, duke e pasur parasysh se e kam caktuar afatin kohor dhe ai ka përfunduar. Me çka jam i obliguar në këtë rast?

Përgjigje: Lavdi Allahut. Ty të takon që të përpiqesh në këtë dhe, kur ke mangësi në ndonjë prej ditëve, duhet t’i pendohesh Allahut për këtë dhe s’ke nevojë të bësh shlyerje/kefareti nëse nuk betohesh. Sa i përket rastit kur ky betim bëhet duke e shprehur atë [me fjalë], si psh: ‘Pasha Allahun’, atëherë duhesh të bësh *kefareti*, për shkak të thënies së Allahut të lartësuar në suren Maideh:

« Allahu nuk je mer në përgjegjësi për betimet e rastësishme, por ju mer në përgjegjësi për betimet e qëllimta. Shlyerje për këtë është të ushqyerit e dhjetë varfnjakëve me mesataren e asaj që ushqeni familjën tuaj ose t’i vishni ata, ose ta lironi një rob. Kush nuk ka mundësi për këtë, le të agjërojë tri ditë. Ky është kefareti për betimin tuaj, kur të betoheni. Ruani betim tuaj. Kështu jua sqaron Allahu ajetet e tij, në mënyrë që të falenderoni »